



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 939 | 1 prot.

Tiranë më/3 .5 .2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin “Për mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”

### MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1993/6 prot., datë 05.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 939 prot., datë 09.05.2022, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimin “Për mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Fillimisht, lidhur me pikën 6 të projektvendimit e cila përcakton se, “Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor” ose Baza e të dhënave shtetërore ALBIS, ndërvepron me baza të tjera të të dhënave shtetërore, konkretisht Regjistri i Gjendjes Civile, Zyra e Komisionerit ju bën me dije se, Udhëzimi i përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, (në vijim, “Udhëzimi”) i Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në pikën 1 të tij përcakton se:

*“Institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë) mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltar dhe nga aktet e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë ju njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin përcaktohet në aneksin 1 të këtij Udhëzimi”.*

Në vijim, në pikën 4 të po këtij Udhëzimi, përcaktohet se, për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe midis

Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kontrolluesit përkatës dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër, me qëllim legjitimimin e aksesit të bazës e të dhënave shtetërore ALBIS, në të dhënat personale të Regjistrit të Gjendjes Civile duhen zbatuar parashikimet e Udhëzimit të sipërpërmendur.

Gjithashtu, lidhur me pikën 10, të projektvendimit, Zyra e Komisionerit sugjeron riformulimin e kësaj pike, duke shtuar në fund të paragrafit këtë përmbajtje:

*Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korigjimin, përhapjen e të dhënave, etj, duhet të lerë gjurmë me qëllim garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave”.*

Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit konstaton se, në përmbajtje të projektvendimit nuk janë përcaktuar afate për kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale në përmbushje të detyrimit që buron nga neni 5, germa “d” e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, e cila përcakton se, mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Me përfshirjen e sugjerimeve të sipërpërmendura, projektvendimi vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

